



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Objekti: “Rikonstruksion total i Pallatit të Sportit ‘Qazim Dervishi’ – Faza e parë”

Lloji i kontratës: Punë

Procedura: Procedurë e hapur

Kodi kryesor CPV: 45331000-6 – Punime për instalimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit

Afati i realizimit: 4 (katër) muaj

Fondi limit: 49 218 876,00 (dyzet e nëntë milionë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë. Fondi limit përbëhet nga 22 686 876,00 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë për punimet dhe fondin rezervë, pa TVSH, dhe 26 532 000,00 (njëzet e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë për pajisjet, me TVSH në shitje të përfshirë. TVSH-ja në masën 20% mbi punimet dhe fondin rezervë është 4 537 375,20 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë. Vlera e përgjithshme e financimit është 53 756 251,20 (pesëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një pikë njëzet) lekë.

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe neneve 2, pika 2, shkronja “c”, dhe 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Procedura zhvillohet si “Procedurë e hapur – Punë”, pasi fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar dhe nën kufirin e lartë monetar për punët publike, sipas VKM-së nr. 291, datë 15.5.2024, të ndryshuar.

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit janë hartuar mbi bazën e projektit, preventivit, analizave teknike dhe grafikut të punimeve. Ato lidhen drejtpërdrejt dhe janë në përpjesëtim me

natyrën, vëllimin, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, në respektim të parimeve të konkurrencës, transparencës, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit;

b) Sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme mbështeten në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; nenet 26 dhe 30 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”, të miratuara me vendimin e APP-së nr. 10, datë 23.9.2024.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit shërben si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe mungesën e shkaqeve të përjashtimit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, formulari paraqitet nga secili anëtar i bashkimit. Formulari paraqitet veçmas edhe nga çdo subjekt, në kapacitetet e të cilit mbështetet ofertuesi.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, Autoriteti Kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar dhe të renditur të parin dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e bëra. Dokumentacioni duhet të provojë gjendjen faktike të ofertuesit në momentin e paraqitjes së ofertës dhe verifikohet sipas legjislacionit në fuqi.

Sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin dhe vlefshmërinë e ofertës, si dhe mbrojtjen e Autoritetit Kontraktor në rastet e parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Ai duhet të paraqitet sipas Shtojcës 3 dhe të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se është i regjistruar në regjistrin profesional ose tregtar dhe se ushtron veprimtari në përputhje me objektin e kontratës.

Përmbushja e kriterit deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili anëtar duhet ta përmbushë kriterin në përputhje me pjesën e punimeve që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, si dhe nenin 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; nenin 26 dhe nenin 39, pika 6, shkronja “b”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Kërkesa synon të verifikojë se operatori ekonomik është i regjistruar ligjërisht dhe ushtron veprimtari që lidhet me punimet që merr përsipër të realizojë. Objekti përfshin instalimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit, instalime elektrike, konstruksione metalike, si dhe furnizimin, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të pajisjeve teknologjike dhe sportive.

Për ofertuesin e kualifikuar dhe të renditur të parin, Autoriteti Kontraktor verifikon të dhënat e regjistrimit dhe veprimtarinë nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit ose dokumentacionit provues, kur të dhënat nuk mund të sigurohen nga një bazë zyrtare.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt dhe është në përpjesëtim me objektin e kontratës, pa vendosur kufizime të panevojshme ndaj konkurrencës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të konfirmuara pranë administratës tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të periudhës së kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kriteri përmbushet nga bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes së secilit anëtar, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri mbështetet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; nenin 43, pikat 4 dhe 6, si dhe nenin 88, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar; legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Kërkesa synon të verifikojë qëndrueshmërinë financiare dhe aftësinë e operatorit ekonomik për të përballuar detyrimet e kontratës. Objekti kërkon angazhim financiar për furnizimin, transportin, instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve teknologjike, si dhe për angazhimin e personelit dhe mjeteve teknike brenda afatit katërmujor.

Kërkesa për dy bilance të njëpasnjëshme pa raport negativ është në përputhje me nenin 43, pika 4, të VKM-së nr. 285/2021 dhe është proporcionale me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore të realizuar gjatë viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025.

Vlera e xhiros së realizuar në të paktën një nga vitet e kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit, përkatësisht **19 687 550,40 lekë**.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kriteri përmbushet nga bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes së secilit anëtar, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri mbështetet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; nenin 43, pikat 1, 2, shkronja “b”, 3 dhe 6, si dhe nenin 88, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Fondi limit ndodhet ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar për kontratat e punëve publike. Për këto procedura, xhiroja minimale e kërkuar nuk mund të tejkalojë vlerën e përllëgoaritur të kontratës. Kërkesa në masën 40% është më e ulët se kufiri maksimal ligjor dhe synon të verifikojë kapacitetin financiar pa kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

Objekti kërkon angazhim financiar për porositjen, furnizimin, transportin, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të pajisjeve AHU dhe VRF, si dhe për realizimin e punimeve mekanike, elektrike dhe metalike brenda afatit katërmujor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse vlera minimale e xhiros arrihet në të paktën një nga tri vitet financiare të kërkuara. Kërkesa është e lidhur dhe në përpjesëtim me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara për taksat dhe tarifatat vendore deri në datën e fundit të paraqitjes së ofertave, përfshirë detyrimet dhe këstet e maturuara të vitit 2026, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas adresave të regjistruara në QKB.

Përmbushja e kriterit provohet me vërtetime të lëshuara nga njësiti përkatës të vetëqeverisjes vendore. Vërtetimet duhet të pasqyrojnë gjendjen e operatorit ekonomik në datën e fundit të paraqitjes së ofertave.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kriteri duhet të përmbushet veçmas nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi

Kriteri mbështetet në nenin 76, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Kërkesa synon të verifikojë përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore në të gjitha njësitë ku operatori ekonomik ushtron aktivitet. Për vitin 2026 kërkohet vetëm shlyerja e detyrimeve dhe kësteve që kanë arritur afatin e pagesës deri në datën e fundit të paraqitjes së ofertave, sipas afateve të përcaktuara nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

Kriteri nuk përfshin kështu pamaturuara dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të provojë realizimin me sukses të punëve të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, duke përmbushur njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit, përkatësisht **19 687 550,40 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë pikë dyzet) lekë;**

ose

b) punë të ngjashme të realizuara në disa kontrata, me vlerë të përgjithshme jo më të vogël se 80% e fondit limit, përkatësisht **39 375 100,80 (tridhjetë e nëntë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind pikë tetëdhjetë) lekë.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të mësipërme e bën ofertën të kualifikueshme.

Do të konsiderohen punë të ngjashme punimet për instalimin, rikonstruksionin ose rehabilitimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit, përfshirë komponentët mekanikë, elektrikë dhe/ose strukturat mbështetëse që lidhen me këto sisteme.

Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik:** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

b) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat:** vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së

bërë, të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kërkesat për përvojën e mëparshme përmbushen nga bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes së secilit anëtar, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Kushti i përcaktuar në shkronjën “a” përmbushet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes së tyre.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; nenit 39, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 88, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; si dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Sipas nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose punë të ngjashme të realizuara në disa kontrata, të marra së bashku, deri në dyfishin e fondit limit.

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën në masën 40% për një objekt të vetëm ose 80% për disa kontrata:

- $49\,218\,876,00 \text{ lekë} \times 40\% = 19\,687\,550,40 \text{ lekë};$
- $49\,218\,876,00 \text{ lekë} \times 80\% = 39\,375\,100,80 \text{ lekë}.$

Vlerat e kërkuara janë më të ulëta se kufijtë maksimalë të lejuar nga legjislacioni dhe synojnë të verifikojnë përvojën e operatorit ekonomik pa kufizuar në mënyrë të pajustificuar konkurrencën.

Përkufizimi i punëve të ngjashme lidhet me komponentin kryesor të kontratës, i cili përfshin instalimin dhe vënien në funksion të sistemeve AHU dhe VRF, kanalet e ajrit, tubacionet e gazit ftohës, instalimet elektrike dhe konstruksionet mbështetëse përkatëse.

Përvoja nuk kufizohet sipas llojit ose destinacionit të ndërtesës ku janë realizuar punimet. Pranohen punë të realizuara në objekte publike ose private, për sa kohë që natyra e tyre është e ngjashme me punimet kryesore objekt prokurimi.

Kriteri është i lidhur dhe në përpjesëtim me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës dhe synon të verifikojë aftësinë teknike të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të saj.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent, e cila duhet të përfshijë kategoritë dhe nivelet minimale:

- **N.S-12, niveli A** – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S-8, niveli A** – Ndërtime parafabrikate me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;
- **N.S-14, niveli A** – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV etj.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë kategoritë e licencës që lidhen me punimet që ka marrë përsipër të realizojë, sipas ndarjes së punimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 39, pikat 4 dhe 6, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Sipas nenit 39, pika 6, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë licencat profesionale të shoqërisë që janë të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate. Kategoritë e kërkuara janë përcaktuar pas shqyrtimit të projektit, preventivit, analizave teknike dhe specifikimeve teknike, duke u lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe vlerën e punimeve përkatëse.

N.S-12, niveli A – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Kategoria N.S-12 kërkohet për realizimin e komponentit kryesor të kontratës, i cili përfshin:

- instalimin e tubacioneve të bakrit për gazin ftohës;
- instalimin e degëzuesve, rakorderive dhe aksesoreve të sistemit VRF;
- vakumimin, testimin dhe mbushjen e sistemit me gaz ftohës;
- instalimin e kитеve DX për lidhjen e njësive AHU me sistemin VRF;
- prodhimin dhe instalimin e kanaleve të ajrit;
- instalimin e difuzorëve dhe grilave të rikthimit;
- montimin e njësive të trajtimit të ajrit AHU;
- montimin e njësive të jashtme të sistemit VRF;
- lidhjen, testimin dhe vënien në funksion të sistemit të kondicionimit.

Këto punime evidentohen kryesisht në zërat An.M03, An.M05, An.M06, An.M09, An.M10, An.M12, An.M13, An.M15, An.M19, An.V01–An.V03, An.MP-01 dhe An.MP-02 të preventivit.

Vlera orientuese e punimeve që lidhen me këtë kategori është rreth 10 192 702,56 lekë pa TVSH, pa përfshirë vlerën e pajisjeve që furnizohen si mallra teknologjike.

Kategoria N.S-12 përfshin edhe punimet plotësuese ose ndihmëse të muraturës që janë të nevojshme për realizimin e instalimeve përkatëse.

N.S-8, niveli A – Struktura metalike

Kategoria N.S-8 kërkohet për prodhimin dhe montimin e konstruksioneve metalike, suporteve dhe elementeve mbështetëse që nevojiten për instalimin e kanaleve të ajrit dhe instalimeve elektrike.

Kjo kategori lidhet kryesisht me zërat:

- 4.3 – Konstruksione metalike të thjeshta;
- An.V04 – Konstruksione metalike për montimin e kanaleve të ajrit;
- An.E15 – Konstruksione metalike dhe aksesore për mbështetjen e kanalave elektrike.

Vlera orientuese e punimeve që lidhen me këtë kategori është rreth **642 408,81 lekë pa TVSH**.

Zëri 3.303, “Skelë metalike deri në 10 m”, nuk është përfshirë në argumentimin e kategorisë N.S-8, pasi skleria është mjet ose strukturë e përkohshme ndihmëse dhe nuk përbën strukturë metalike të përhershme objekt zbatimi.

N.S-14, niveli A – Impiante të brendshme elektrike

Kategoria N.S-14 kërkohet për realizimin e punimeve elektrike dhe të komunikimit, duke përfshirë:

- kutitë shpërndarëse;
- panelet elektrike kryesore dhe panelet HVAC;
- kabllot elektrike të tensionit të ulët;
- kabllot e komunikimit të sistemit;
- kanalinat metalike dhe aksesoret;
- tubacionet mbrojtëse të instalimeve elektrike;
- lidhjen elektrike dhe të komunikimit të pajisjeve teknologjike;
- instalimet elektrike të pajisjeve elektronike sportive;
- testimin dhe vënien në funksion të instalimeve.

Kjo kategori lidhet kryesisht me zërat 4.155/5, An.M14, An.E01–An.E03, An.E05–An.E14, An.E16–An.E21, An.E23, An.F02 dhe An.F03 të preventivit.

Vlera orientuese e punimeve që lidhen me këtë kategori është rreth **5 288 403,85 lekë pa TVSH**.

Argumentimi i niveleve

Niveli A është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e punimeve që lidhen me secilën kategori dhe kufijtë financiarë të parashikuar nga legjislacioni për licencimin profesional. Vlera e punimeve të identifikuara për secilën kategori nuk tejkalon kufirin financiar të nivelit A.

Në përcaktimin e nivelit nuk është përfshirë vlera e pajisjeve që furnizohen si mallra teknologjike ose sportive, por vetëm vlera e punimeve që kërkojnë licencimin përkatës.

Kategoritë dhe nivelet e kërkuara përfaqësojnë minimumin profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës. Ato lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit, natyrën dhe vlerën e punimeve dhe nuk krijojnë kërkesa të panevojshme apo barriera të pajustificuara ndaj konkurrencës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin kryesor inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier mekanik;
- 1 (një) inxhinier elektrik.

Inxhinierët duhet të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave.

Personeli i mësipërm duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën profesionale të shoqërisë, në përputhje me kategoritë e punimeve që mbulon, përkatësisht:

- inxhinieri i ndërtimit për kategorinë **N.S-8**;
- inxhinieri mekanik për kategorinë **N.S-12**;
- inxhinieri elektrik për kategorinë **N.S-14**.

Inxhinieri mekanik duhet të përcaktohet nga operatori ekonomik si përgjegjës për koordinimin teknik të kontratës, për shkak të natyrës mbizotëruese të punimeve mekanike dhe të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit.

Përmbushja paraprake e këtij kriteri deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar dhe i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- diplomat përkatëse;
- kontratat individuale të punës, të vlefshme në datën e hapjes së ofertave;
- listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave;

- licencën profesionale të shoqërisë, nga e cila rezulton përfshirja e inxhinierëve si drejtues teknikë për kategoritë përkatëse;
- deklaratën e administratorit për përcaktimin e inxhinierit mekanik si përgjegjës për koordinimin teknik të kontratës dhe konfirmimin e disponueshmërisë së personelit gjatë zbatimit të saj.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kriter përmbushet nga bashkimi, në përputhje me ndarjen e punimeve të përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Secili inxhinier duhet të jetë i punësuar pranë anëtarit të bashkimit që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet profili përkatës, ndërsa ky anëtar duhet të disponojë edhe kategorinë përkatëse të licencës profesionale.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 26, nenit 39, pikat 4 dhe 6, shkronja “c”, dhe nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;
- VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Në përputhje me nenin 39, pika 6, shkronja “c”, të VKM-së nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë personelin kryesor të nevojshëm për realizimin e kontratës, si dhe dokumentacionin që provon kualifikimin dhe marrëdhënien e punës së këtij personeli.

Kërkesa për tre profilet inxhinierike lidhet drejtpërdrejt me kategoritë e licencës profesionale dhe me natyrën e punimeve të parashikuara në projekt, preventiv dhe specifikimet teknike.

Inxhinieri mekanik kërkohet për drejtimin dhe kontrollin e punimeve që lidhen me njësitë AHU dhe VRF, tubacionet e gazit ftohës, kanalet e ajrit, degëzuesit, rakorderitë, aksesoret, testimin dhe vënien në funksion të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit. Përcaktimi i tij si përgjegjës për koordinimin teknik justifikohet nga pesha dhe rëndësia funksionale e komponentit mekanik në kontratë, si dhe nga nevoja për koordinimin e ndërfaqeve ndërmjet instalimeve mekanike, elektrike dhe konstruksioneve mbështetëse.

Inxhinieri i ndërtimit kërkohet për drejtimin dhe kontrollin e realizimit të konstruksioneve metalike, suporteve, bazamenteve, elementeve mbajtëse dhe punimeve ndihmëse civile që lidhen me instalimin e pajisjeve teknologjike.

Inxhinieri elektrik kërkohet për drejtimin dhe kontrollin e instalimit të paneleve elektrike, kanalave, kabllave të fuqisë dhe komunikimit, sistemeve të komandimit, lidhjeve elektrike të pajisjeve teknologjike dhe vënies në funksion të instalimeve elektrike.

Kërkesa që inxhinierët të figurojnë në listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave synon të provojë ekzistencën e një marrëdhënieje reale dhe aktuale pune në momentin e ofertimit. Kufizimi i verifikimit vetëm në muajin e fundit të deklaruar është proporcional dhe nuk vendos kushte të panevojshme për një periudhë më të gjatë punësimi.

Përfshirja e inxhinierëve si drejtues teknikë në licencën profesionale siguron përputhjen ndërmjet personelit të deklaruar, kategorive të licencimit dhe punimeve konkrete që operatori ekonomik do të marrë përsipër.

Numri dhe profilet e kërkuara përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për realizimin paralel dhe të koordinuar të punimeve brenda afatit katërmujor. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt dhe në përpjesëtim me objektin, kompleksitetin dhe kategoritë e punimeve, pa krijuar kufizime të pajustificuara ndaj konkurrencës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se **24 (njëzet e katër) punonjës të siguruar**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave.

Në këtë numër përfshihen 3 (tre) inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.3 dhe personeli i mëposhtëm:

Profili	Numri minimal
Teknik ndërtimi	1
Teknik mekanik	1
Teknik elektrik	1
Punëtorë të thjeshtë	5
Saldatorë	3
Instalues mekanikë/HVAC	6
Elektracistë	4
Totali, pa përfshirë inxhinierët	21
Totali i përgjithshëm, përfshirë 3 inxhinierët	24

Punonjësit duhet të jenë persona të ndryshëm dhe secili punonjës llogaritet vetëm një herë për përmbushjen e numrit minimal.

Kriteri përmbushet paraprakisht nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të paraqesë:

- listëpagesën e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave;
- kontratat individuale të punës;
- diplomat ose dëshmitë e kualifikimit për teknikët;
- dëshmi kualifikimi profesional për saldatorët, instaluesit mekanikë/HVAC dhe elektrikistët.

Për punëtorët e thjeshtë nuk kërkohet dëshmi e posaçme kualifikimi.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, numri dhe profilet e personelit mund të përmbushen bashkërisht nga anëtarët, në përputhje me ndarjen e punimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 26 dhe nenit 39, pikat 4 dhe 6, shkronjat “c” dhe “ç”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- nenit 88 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, për bashkimet e operatorëve ekonomikë;
- ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Numri dhe profilet e personelit janë përcaktuar drejtpërdrejt mbi bazën e grafikut të miratuar të punimeve, preventivit, natyrës së punimeve dhe afatit kontraktor prej 4 (katër) muajsh.

Grafiku i punimeve parashikon angazhimin e personelit sipas kësaj strukture:

- 5 punëtorë të thjeshtë;
- 3 punëtorë të specializuar për konstruksionet metalike dhe saldimin;
- 6 punëtorë të specializuar për instalimet mekanike dhe sistemet HVAC;
- 4 punëtorë të specializuar për instalimet elektrike, elektronike, tokëzimin dhe ndriçimin;
- 1 teknik ndërtimi, 1 teknik mekanik dhe 1 teknik elektrik;
- 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier mekanik dhe 1 inxhinier elektrik.

Punëtorët e thjeshtë kërkohen për transportin dhe sistemimin e materialeve brenda kantierit, asistencën në përgatitjen e fronteve të punës, pastrimin dhe punimet e tjera ndihmëse.

Saldatorët kërkohen për realizimin dhe montimin e konstruksioneve metalike, suporteve, bazamenteve dhe elementeve mbështetëse të pajisjeve dhe instalimeve.

Instaluesit mekanikë/HVAC kërkohen për instalimin e tubacioneve të bakrit, kanaleve të ajrit, degëzuesve, rakorderive, difuzorëve, grilave, njësi AHU, sistemit VRF dhe komponentëve përkatës.

Elektricitetët kërkojnë për instalimin e paneleve elektrike, kanalinave, kabllave të fuqisë dhe komunikimit, sistemeve të komandimit, tokëzimit dhe lidhjeve elektrike të pajisjeve.

Personeli teknik kërkojnë për ndjekjen e përditshme të punimeve në kantier, kontrollin e zbatimit të detajeve teknike dhe mbështetjen e inxhinierëve përgjegjës për disiplinat përkatëse.

Inxhinierët përfaqësojnë personelin kryesor drejtues dhe janë argumentuar veçmas në pikën 2.3.3.

Kërkesa që personeli të figurojë në listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave synon të provojë ekzistencën e një marrëdhënieje reale dhe aktuale pune, pa kërkuar një periudhë më të gjatë punësimi.

Numri minimal prej 24 punonjësish është i njëjtë me personelin e evidentuar në grafikun e punimeve dhe përfaqëson kapacitetin e nevojshëm për realizimin paralel të punimeve brenda afatit katërmujor. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt dhe në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi, me qira, huapërdorje ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme disponimi, mjetet dhe pajisjet minimale të mëposhtme:

Nr.	Mjeti/pajisja	Sasia minimale
1	Skeleri metalike dhe rrjeta mbrojtëse/rrëthimi	600 m ²
2	Metër lazer	4 copë
3	Elektrosaldatrice	2 copë
4	Trapan elektrik/profesional	2 copë

Kriteri përmbushet paraprakisht nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të paraqesë:

- për pajisjet në pronësi: faturë tatimore blerjeje, deklaratë doganore, regjistër inventari ose dokument tjetër të ligjshëm që provon pronësinë dhe sasinë;
- për pajisjet me qira, huapërdorje ose në një formë tjetër disponimi: kontratën përkatëse dhe dokumentacionin që provon pronësinë e pajisjeve nga dhënësi në përdorim;
- skeda teknike ose dokumentacion tjetër, kur dokumentet e pronësisë nuk mundësojnë identifikimin e llojit, kapacitetit ose sasisë së pajisjes.

Dokumentacioni duhet të provojë se mjetet dhe pajisjet do të jenë në dispozicion të operatorit ekonomik gjatë periudhës kur kërkojnë përdorimi i tyre sipas grafikut të punimeve.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, mjetet dhe pajisjet mund të disponohen bashkërisht nga një ose disa anëtarë të bashkimit.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 26 dhe nenit 39, pikat 4 dhe 6, shkronja “d”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- nenit 88 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar;
- ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Lloji dhe sasia e mjeteve janë përcaktuar në përputhje me grafikun e miratuar të punimeve, preventivin, natyrën e punimeve dhe organizimin e fronteve të punës.

- **Skleria metalike dhe rrjetat mbrojtëse/rrethuese prej 600 m²** kërkohen për realizimin e sigurt të instalimeve mekanike, kanaleve të ajrit, instalimeve elektrike dhe elementeve mbështetëse në lartësi, si dhe për mbrojtjen dhe kufizimin e zonave të punës.
- **Katër metrat lazer** kërkohen për matjen, nivelimin dhe pozicionimin e tubacioneve, kanaleve të ajrit, kanalinave elektrike, suporteve dhe pajisjeve në fronte pune që mund të zhvillohen paralelisht.
- **Dy elektrosaldatricet** kërkohen për realizimin dhe montimin e konstruksioneve metalike, suporteve, bazamenteve dhe elementeve mbështetëse të pajisjeve dhe instalimeve.
- **Dy trapanat elektrikë/profesionalë** kërkohen për hapjen e vrimave, vendosjen e ankorimeve, montimin e suporteve, kanalinave, tubacioneve dhe elementeve të tjera të instalimeve mekanike dhe elektrike.

Lejimi i disponimit të mjeteve në pronësi, me qira, huapërdorje ose nëpërmjet një forme tjetër të ligjshme shmang kufizimin e operatorëve që nuk i kanë pajisjet në pronësi, por mund t’i sigurojnë ato për zbatimin e kontratës.

Kërkesa përfaqëson minimumin e parashikuar në grafikun e punimeve dhe është e lidhur drejtpërdrejt dhe në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe afatin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të vlefshme në datën e fundit të paraqitjes së ofertave:

- **ISO 9001:2015** – Sistemi i menaxhimit të cilësisë, ose ekuivalente;
- **ISO 14001:2015** – Sistemi i menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente;
- **ISO 45001:2018** – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, ose ekuivalente.

Fusha e certifikimit duhet të lidhet me zbatimin e punimeve të ndërtimit, instalimin e sistemeve mekanike, termike, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit, instalimet elektrike, konstruksionet

metalike ose veprimtari të tjera të ngjashme me pjesën e punimeve që operatori ekonomik merr përsipër të realizojë.

Certifikatat duhet:

- të jenë të vlefshme në datën e fundit të paraqitjes së ofertave;
- të jenë lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar për fushën përkatëse.

Do të pranohen certifikata të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga një organizëm kombëtar akreditues i një shteti tjetër, nënshkrues i marrëveshjeve shumëpalëshe të njohjes reciproke për fushën përkatëse të akreditimit.

Argumentimi

Kërkesa është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 77, pika 4, dhe nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë certifikata të lëshuara nga organizma të pavarur dhe të akredituar, kur standardet e kërkuara lidhen me natyrën e objektit të prokurimit dhe janë në përpjesëtim me të.

Objekti i kontratës përfshin instalimin, testimin dhe vënien në funksion të sistemeve mekanike, termike, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit, realizimin e instalimeve elektrike dhe të konstruksioneve metalike, si dhe furnizimin dhe montimin e pajisjeve teknologjike. Për këtë arsye, zbatimi i kontratës kërkon administrimin e koordinuar të cilësisë, ndikimeve mjedisore dhe rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë.

ISO 9001:2015, ose ekuivalente, kërkohet për të verifikuar se operatori ekonomik zbaton një sistem të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë për kontrollin e materialeve dhe pajisjeve, proceseve të instalimit, testimeve, trajtimin e mospërputhjeve dhe dokumentimin e punimeve të realizuara.

Kjo kërkesë lidhet veçanërisht me instalimin dhe integrimin e njësive AHU dhe VRF, sistemeve të komandimit, paneleve elektrike dhe pajisjeve të tjera teknologjike, funksionimi i të cilave varet nga zbatimi dhe kontrolli i saktë i të gjitha proceseve teknike.

ISO 14001:2015, ose ekuivalente, kërkohet për të verifikuar se operatori ekonomik disponon një sistem për identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore që mund të krijohen gjatë realizimit të punimeve.

Këto ndikime lidhen me krijimin dhe largimin e mbetjeve të ndërtimit, administrimin e materialeve metalike dhe ambalazheve, transportin e materialeve dhe pajisjeve, përdorimin e gazeve ftohëse të parashikuara në projekt, si dhe kontrollin e pluhurave, zhurmave dhe shkarkimeve të mundshme gjatë punimeve.

ISO 45001:2018, ose ekuivalente, kërkohet për shkak të rreziqeve që lidhen me punimet në lartësi, përdorimin e skelerive, saldimin, instalimet elektrike, ngritjen dhe pozicionimin e pajisjeve, si dhe montimin e pajisjeve të rënda teknologjike.

Ky standard verifikon ekzistencën e një sistemi të organizuar për identifikimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, menaxhimin e incidenteve dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa që fusha e certifikimit të lidhet me punimet që operatori ekonomik merr përsipër synon të sigurojë që certifikatat të jenë të zbatueshme konkretisht për objektin e kontratës dhe jo vetëm të dëshmojnë një certifikim të përgjithshëm në një veprimtari të palidhur.

Kërkesa për akreditimin e organizmit të vlerësimit të konformitetit shërben për të garantuar besueshmërinë, vlefshmërinë dhe mundësinë e verifikimit të certifikatave. Pranimi i certifikatave të lëshuara nga organizma të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma kombëtarë akreditues të shteteve të tjera, nënshkrues të marrëveshjeve shumëpalëshe të njohjes reciproke, garanton trajtim të barabartë dhe nuk e kufizon konkurrencën vetëm te organizmat certifikues vendas.

Kërkesa për standarde ekuivalente mundëson pranimin e certifikimeve që garantojnë një nivel të barasvlershëm të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë e shëndetit në punë.

Për rrjedhojë, kërkesa për këto tri certifikata lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe rreziqet e kontratës, është në përpjesëtim me objektin e saj dhe nuk vendos kufizime të pajustificuara ndaj pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori/përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet kryesore të sistemit të kondicionimit, përkatësisht:

- njësitë e trajtimit të ajrit – AHU;
- njësitë e jashtme të sistemit VRF;
- pajisjet e komandimit, kontrollit dhe komponentët që janë pjesë integrale e funksionimit të këtyre sistemeve.

Autorizimi duhet:

- të jetë i vlefshëm në datën e fundit të paraqitjes së ofertave;
- të jetë lëshuar në emër të operatorit ekonomik ofertues;
- të identifikojë prodhuesin ose distributorin/përfaqësuesin e autorizuar;
- të identifikojë pajisjet ose markën e pajisjeve që operatori ekonomik propozon të furnizojë;
- të konfirmojë të drejtën e operatorit ekonomik për të ofertuar dhe furnizuar pajisjet e propozuara;
- të përmbajë të dhëna që mundësojnë verifikimin e tij nga Autoriteti Kontraktor.

Kur autorizimi lëshohet nga distributori ose përfaqësuesi i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentin që provon marrëdhënien e autorizimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit/përfaqësuesit.

Në rast se operatori ekonomik është vetë prodhues i pajisjeve të ofruara, autorizimi zëvendësohet me një deklaratë të operatorit ekonomik dhe me dokumentacionin që provon statusin e tij si prodhues.

Dokumentacioni duhet të paraqitet në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e ofertës. Dokumentet e hartuara në gjuhë të huaj duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe, në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, autorizimi duhet të paraqitet në emër të anëtarit të bashkimit që, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ka marrë përsipër furnizimin dhe instalimin e pajisjeve përkatëse.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 36 dhe nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 39, pikat 4 dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Objekti i kontratës përfshin furnizimin, instalimin, lidhjen, testimin dhe vënien në funksion të njësive të trajtimit të ajrit AHU dhe të sistemit VRF. Këto pajisje kanë vlerë të konsiderueshme dhe përbëjnë komponentët kryesorë teknologjikë për realizimin e sistemit të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të objektit.

Funksionimi i sistemit përfundimtar varet nga përputhshmëria teknike ndërmjet njësive AHU, njësive VRF, pajisjeve të komandimit, kontrollit dhe komponentëve të tjerë të sistemit. Për këtë arsye, është e nevojshme të verifikohet se pajisjet e propozuara sigurohen nëpërmjet një burimi të autorizuar dhe se operatori ekonomik ka të drejtë t’i ofertojë dhe furnizojë ato.

Autorizimi shërben për të garantuar:

- origjinën dhe autenticitetin e pajisjeve;
- furnizimin e rregullt të pajisjeve të propozuara;
- përputhshmërinë ndërmjet komponentëve të sistemit;
- mundësinë e sigurimit të dokumentacionit teknik;
- zbatimin e kushteve të garancisë së prodhuesit;
- sigurimin e mbështetjes teknike dhe të pjesëve të këmbimit gjatë periudhës së garancisë.

Kërkesa është kufizuar vetëm te pajisjet kryesore të sistemit të kondicionimit dhe nuk zbatohet për materialet ose aksesorët e zakonshëm të instalimit. Kjo për shkak se pajisjet AHU, VRF dhe komponentët integralë të tyre kërkojnë garanci të dokumentuar për origjinën, përputhshmërinë, mbështetjen teknike dhe funksionimin si një sistem i integruar.

Pranimi i autorizimit nga prodhuesi ose nga distributori/përfaqësuesi i autorizuar prej tij shmang krijimin e një marrëdhënieje të detyrueshme të drejtpërdrejtë ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit. Kur autorizimi lëshohet nga distributori, kërkesa për dokumentimin e lidhjes së tij me prodhuesin shërben vetëm për të verifikuar vlefshmërinë e zinxhirit të autorizimit.

Kriteri nuk përcakton markë ose prodhues të caktuar. Çdo operator ekonomik mund të ofrojë pajisje të çdo prodhuesi që përmbushin specifikimet teknike dhe për të cilat mund të paraqitet autorizimi përkatës.

Për rrjedhojë, kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, vlerën dhe rëndësinë funksionale të pajisjeve të kondicionimit, është proporcional me objektin e kontratës dhe nuk vendos kufizime të pajustificuara ndaj konkurrencës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, skeda teknike ose dokumentacion tjetër zyrtar të prodhuesit për pajisjet kryesore të sistemit të kondicionimit, përkatësisht:

- njësitë e trajtimit të ajrit – AHU;
- njësitë e jashtme të sistemit VRF;
- pajisjet e komandimit dhe kontrollit;
- kitet DX dhe komponentët e tjerë kryesorë që janë pjesë integrale e funksionimit të sistemit.

Dokumentacioni teknik duhet:

- të identifikojë qartë prodhuesin, markën dhe modelin e pajisjes së ofruar;
- të përmbajë të dhënat teknike të nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike;
- të jetë dokumentacion zyrtar i prodhuesit, në format të printuar ose elektronik;
- të ketë të evidentuara ose të nënvizuara parametrat teknikë që lidhen me kërkesat e Autoritetit Kontraktor;
- të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të pjesëve përkatëse, kur është hartuar në gjuhë të huaj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe një tabelë përputhshmërie, në të cilën, për çdo parametër të kërkuar në specifikimet teknike, të përcaktojë:

- parametrin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;
- parametrin e pajisjes së ofruar;
- markën dhe modelin;
- faqen ose seksionin e katalogut/skedës teknike ku provohet përmbushja e kërkesës.

Kur për pajisjen e ofruar kërkohet sipas legjislacionit të zbatueshëm, duhet të paraqitet edhe deklarata ose certifikata e konformitetit **CE**, ose dokumenti ekuivalent i konformitetit.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të paraqitet në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e ofertës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentacioni paraqitet nga anëtari që, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ka marrë përsipër furnizimin dhe instalimin e pajisjeve përkatëse.

Argumentimi

Kriteri është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 36 dhe nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën “Procedurë e hapur – Punë”.

Objekti i kontratës përfshin furnizimin, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të pajisjeve teknologjike me rëndësi thelbësore për funksionimin e sistemit të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit.

Katalogët dhe skedat teknike janë të nevojshme për të verifikuar në mënyrë objektive nëse pajisjet e propozuara përmbushin parametrat e përcaktuar në projekt dhe në specifikimet teknike, përfshirë, sipas rastit:

- kapacitetin termik dhe ftohës;
- prurjen dhe presionin e ajrit;
- fuqinë elektrike dhe konsumin;
- nivelin e zhurmës;
- përmasat dhe peshën;
- llojin e gazit ftohës;
- eficiencën energjetike;
- kushtet e funksionimit;
- sistemin e komandimit dhe kontrollit;
- përputhshmërinë ndërmjet komponentëve.

Identifikimi i markës dhe modelit është i nevojshëm për të lidhur pajisjen e propozuar me autorizimin e prodhuesit ose distributorit dhe për të shmangur paraqitjen e dokumentacionit të përgjithshëm që nuk i përket pajisjes së ofertuar.

Tabela e përputhshmërisë lehtëson verifikimin e ofertës dhe siguron që vlerësimi të kryhet mbi të njëjtat të dhëna dhe parametra për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kërkesa për deklaratën ose certifikatën e konformitetit zbatohet vetëm për pajisjet për të cilat ky dokument kërkohet nga legjislacioni përkatës dhe synon të verifikojë përmbushjen e kërkesave të zbatueshme të sigurisë dhe konformitetit teknik.

Kriteri nuk përcakton markë ose prodhues të caktuar. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë pajisje të çdo prodhuesi, me kusht që parametrat e tyre të përmbushin specifikimet teknike.

Për rrjedhojë, kërkesa lidhet drejtpërdrejt me pajisjet që do të furnizohen dhe instalohen, mundëson vlerësimin objektiv të përputhshmërisë teknike dhe nuk krijon kufizime të pajustifikuara ndaj konkurrencës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 39, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Ato janë përgatitur mbi bazën e nevojave të Autoritetit Kontraktor, projektit teknik të miratuar, preventivit, analizave teknike, grafikut të punimeve dhe kushteve ekzistuese të Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi”.

Specifikimet synojnë të garantojnë cilësinë, funksionalitetin, sigurinë, eficiencën energjetike dhe jetëgjatësinë e punimeve, instalimeve dhe pajisjeve, duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

Kërkesat teknike lidhen drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe përfshijnë, ndër të tjera:

- instalimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit;
- furnizimin dhe instalimin e njësive të trajtimit të ajrit AHU;
- furnizimin dhe instalimin e njësive të jashtme të sistemit VRF;
- instalimin e tubacioneve të bakrit, degëzuesve, rakorderive, aksesoreve dhe gazit ftohës;
- prodhimin dhe instalimin e kanaleve të ajrit, difuzorëve dhe grilave;
- realizimin e instalimeve elektrike, përfshirë panelet, kabllot, kanalinat, sistemet e komandimit dhe lidhjet elektrike;
- realizimin e konstruksioneve metalike, suporteve dhe elementeve mbështetëse;
- furnizimin dhe instalimin e pajisjeve sportive dhe elektronike;
- testimin, programimin, balancimin dhe vënien në funksion të sistemeve dhe pajisjeve.

Materialet dhe pajisjet që do të përdoren duhet të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe të përmbushin parametrat minimalë teknikë, funksionalë, të sigurisë dhe të performancës të përcaktuar në projekt, preventiv dhe specifikimet teknike.

Punimet duhet të realizohen në përputhje me:

- projektin teknik të miratuar;
- preventivin dhe analizat teknike;
- specifikimet dhe kushtet teknike të zbatimit;
- grafikun e realizimit të punimeve;
- udhëzimet teknike të prodhuesve të pajisjeve;
- standardet shqiptare, standardet europiane ose standarde ekuivalente të zbatueshme;
- legjislacionin në fuqi për ndërtimin, eficiencën energjetike, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e shëndetit në punë.

Parametrat e pajisjeve janë përcaktuar duke marrë në konsideratë kërkesat e projektit për kapacitetin, fuqinë, prurjen dhe presionin e ajrit, eficiencën energjetike, nivelin e zhurmës, kushtet e funksionimit dhe përputhshmërinë ndërmjet komponentëve të sistemit.

Specifikimet teknike janë formuluar nëpërmjet kërkesave funksionale, teknike dhe të performancës, pa iu referuar një marke, prodhuesi, modeli, patente, origjine ose burimi të caktuar që mund të favorizojë ose përjashtojë operatorë ekonomikë apo produkte të caktuara.

Vetëm kur objekti i prokurimit nuk mund të përshkruhet në mënyrë mjaftueshëm të saktë dhe të kuptueshme nëpërmjet kërkesave funksionale ose teknike, një referencë e tillë mund të përdoret në mënyrë përjashtimore dhe duhet të shoqërohet me shprehjen **“ose ekuivalente”**.

Ekuivalenca do të vlerësohet mbi bazën e parametrave të matshëm të performancës, funksionalitetit, cilësisë, sigurisë, eficiencës energjetike, përputhshmërisë me sistemin dhe standardeve teknike të kërkuara. Autoriteti Kontraktor do të pranojë çdo zgjidhje për të cilën operatori ekonomik provon, me mjete të përshtatshme, se përmbush në mënyrë të barasvlershme kërkesat teknike.

Kërkesat teknike për pajisjet AHU, VRF dhe komponentët përkatës janë përcaktuar për të siguruar që sistemi të funksionojë si një tërësi e integruar. Përputhshmëria ndërmjet komponentëve, sistemit të komandimit dhe parametrave të projektit është e nevojshme për instalimin, testimin dhe vënien në funksion të sistemit.

Specifikimet teknike janë në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e objektit **“Rikonstruktion total i Pallatit të Sportit ‘Qazim Dervishi’ – Faza e parë”**. Ato synojnë realizimin e plotë dhe funksional të objektit, pa krijuar pengesa të pajustificuara ndaj pjesëmarrjes dhe konkurrencës.

